



REI HAXHIU

Nga ëndrra elektrike tek e rinovueshme

Rei e kishte të qartë herët që në fëmijëri: do të bëhej personi kyç, ai që të gjithë i drejtoheshin për çështje të inxhinierisë elektrike.

Një ëndërr e ndërtuar mbi pasionin për teknologjinë dhe besimin tek aftësitë e veta. Por realiteti, siç ndodh shpesh, solli një përplasje të fortë. Në vend të një rruge të drejtpërdrejtë dhe të qartë, ai u përball me mungesën e stabilitetit në treg dhe me vështirësinë për të gjetur një vend ku të mund të rritej profesionalisht e të shfaqte më të mirën e vetes.



Një projekt nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim
dhe Bashkëpunim SDC

Në partneritet me:



Zbatuar nga:



HELVETAS



PARTNERËT SHQIPËRI
PËR NDRYSHIM DHE ZHVILLIM

Drejtimi filloi të qartësohej kur ai u përfshi në sektorin e burimeve të rinovueshme – një fushë në zhvillim të vrullshëm, që i dha mundësinë të punonte në analiza teknike, financiare dhe ekonomike të impjanteve të energjisë së pastër. Ky kontakt i drejtpërdrejtë me një nga sektorët më premtues të së ardhmes, shënoi kthesën që ai kishte nevojë.

Reit e përshkruan veten si një person të hapur, që nuk i trembet sfidave të panjohura. Megjithatë, ai pranon se procesi i formimit profesional ka pasur ndikime të forta, herë pozitive, herë më sfiduese, që kanë ndikuar ndjeshëm në mënyrën si e sheh veten dhe drejtimin që dëshiron të ndjekë.

Në fillim, pasiguritë ishin të pranishme. Dëshirat për të bërë më shumë shpesh ndesheshin me realitetin e mundësive të pakta. E megjithatë, edhe përballë një sistemi që shpesh e shtyn individin drejt vështirësive, ai arriti të ruajë një ekuilibër mes të qenit profesionist në një fushë të caktuar dhe fleksibil në përballje me sfida të reja. Një nga eksperiencat më të veçanta të Reit ishte puna si analist risku për impjante fotovoltaike, një rol që e përjetoi drejtpërdrejt në bashkëpunim me ProCredit Holding, kërkimi rreth teknologjisë së Hidrogjenit

“Ky kërkim bazohej në analiza teknike dhe ekonomike, ndërsa implementimi i tyre realizohej në Europën Jug-Lindore dhe Lindore, sëbashku me Amerikën Jugore”, tregon ai.

Këto kontakte praktike me energjinë diellore dhe menaxhimin e rreziqeve financiare i dhanë një perspektivë të re mbi atë çfarë mund të ofrojë tregu kur je i hapur ndaj përvojave të reja.

Nëse do t'i jepte një këshillë të rinjve në moshën kur ai nisi pasigurinë, ajo do të ishte e qartë: të fokusohet më shumë në aftësitë praktike dhe ndërpersonale, jo vetëm në librat e shkollës. Ato janë ato që të ndihmojnë të lëvizësh me më shumë siguri në një botë të paqëndrueshme.

Rei është një njeri i pavarur, që i merr vetë vendimet e tij dhe nuk ndikohet lehtë nga të tjerët. Pas gjithë rrugëtimit të tij, ai ndjehet i qetë me zgjedhjet që ka bërë dhe me drejtimin profesional që ka ndjekur – një rrugë që, megjithëse jo gjithmonë e lehtë, është ndërtuar mbi guximin për të provuar, aftësinë për të reflektuar dhe durimin për të ndërtuar me hapa të sigurt.

